



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI I SHËNDETËSISË**

---

Tiranë, më 11.03.2020

**K A L L Ë Z I M   P E N A L**

**KALLËZUES:**                    **Grup Deputetësh, anëtar të Komisionit Parlamentar për Shëndetësinë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4 – Tiranë**

**ME OBJEKT:**                    Kallëzim i veprës penale “Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik”, parashikuar nga Neni 267 i Kodit Penal

**KUNDËR:**                        **Shtetasit Sali Berisha, i biri i Ram dhe Sheqere, i datëlindjes 15.10.1944 lindur në Tropojë e banues në Tiranë në rr. Mustafa Matohiti, Pallati 7, Kati 4.**

**BAZA LIGJORE:**                Nenet 280, 283 tëK.Pr.Penale dhe Neni 267 i Kodit Penal

**DREJTUAR:    PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË**

**TIRANË**

I nderuar z. Prokuror!

Bazuar nënenin 267 të Kodit Penal dhe nenet 280 dhe 283 tëK.Pr.Penale parashtrojmë këtë kallëzim penal për veprën penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale tëcënuara.

## I. RRETHANAT E FAKTEVE

Është fakt i njohur botërisht që si shumë vende të tjerë edhe Shqipëria, është prekur këto ditë nga një situatë e rënduar epidemike për shkak të rasteve të para të koronavirusit (Covid-19).

Në këtë situatë, autoritetet dhe institucionet përkatëse kanë marrë të gjitha masat e rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, si dhe situata në terren. Sa më sipër është e rekomandueshme dhe e detyrueshme, si dhe në interes të vendit, në kushtet e një emergjence epidemie, që jo vetëm organet ligjzbatuese të vendit por edhe forcat politike, mediat, aktorë të ndryshëm politikë dhe shoqërorë, por dhe vetë qytetarët të ndihmojnë dhe influencojnë për kapërcimin e situatës duke zbatuar këto masa, si dhe duke përçuar informacione të nevojshme dhe të sakta të cilat duhet të sjellin qetësi dhe besim për qytetarët dhe t'u vinë në ndihmë këtyre të fundit për përballimin me sa më pak pasoja të epidemisë.

Në kundërshtim të hapur me situatën aktuale që po kalon vendi, krijuar nga faktorë objektive, përmes përhapjes së informacioneve të rreme, i akuzuari, Sali Berisha nëpërmjet rrjeteve sociale dhe atyre mediatike të shkruara i është drejtuar një publiku të gjerë duke pasqyruar ngjarje dhe situata paniku, që jo vetëm nuk kanë qetësuar qytetarët në kushtet e emergjencës, por kanë sjell panik duke vështirësuar edhe më tej këtë situatë pandemie që po kalon, jo vetëm vendi ynë, por e gjithë bota.

Konkretisht, i akuzuari nëpërmjet rrjetit social Facebook <https://www.facebook.com/SaliBerisha/>, në mënyrë të vazhdueshme, ka përcjellë tek publiku ngjarje dhe rrethana të pavërteta, në kundërshtim të hapur me gjendjen faktike dhe masat e ndërmarra nga organet kompetente, të cilat janë në gadishmëri të plotë për shërbimin ndaj qytetarëve e për kapërcimin e situatës aktuale.

*Konkretisht:*

1. Në datën 9 Mars 2020, ora 09:23 min, përmes një video-postimi “*Gazeta Vlora ja bën fora*” i akuzuari me pamje të marra nga rrjete të tjera sociale, duke fshehur qëllimisht autorin e këtyre videove dhe duke hequr logot (*në kundërshtim kjo me ligjin për të drejtën e autorit*), ka paraqitur sikur në spitalet tona rajonale mjekët gjatë orarit zyrtar të punës dhe në kushtet e gadishmërisë për emergjencën kombëtare po kërcejnë valle, ndërkohë që nga një verifikim i thjeshtë në rrjetin Youtube rezulton se e njëjta video është realizuar në Iran (<https://www.youtube.com/watch?v=WFH6vypVtKE>) më datën 06.03.2020, dhe kjo video është publikuar nga VivaVideo.

2. Në datën 9 Mars 2020, ora 10:16 min, nëpërmjet postimit në rrjetin social Facebook në artikullin e titulluar “*Mashtrim skandaloz i Edvin Çekapit dhe Ndrikull Hajnisë*”, i akuzuari ka deklaruar se të sëmurët me koronavirusi shtrojnë në spitalin infektiv në të njëjtët shtretër që janë dhe të sëmurët e tjerë infektiv. Ai ka deklaruar gjithashtu se ky është një akt kriminal

që kërcënon në mënyrë serioze jetën e të sëmurëve të shtruar me sëmundje të tjera dhe përhapjen me shpejtësi të epidemisë, postim ky i pashoqëruar me foto apo video që pasqyrojnë këtë realitet nga sa pretendohet.

3. Në datën 9 Mars 2020, ora 12:37 min, nëpërmjet postimit në rrjetin social Facebook me artikullin e titulluar “*Edvin Çekapi dhe Ndrikull Hajnia mashtrojnë shqiptarët*”, i akuzuari deklaroi mes të tjerash se: “*...në Firence nuk ka patur asnjë rast me koronavirus, ...shpallin të importuar dy rastet me koronavirus të ardhur 10 ditë mëparë nga Firence.... ndërkohë që në Firence dy rastet e para janë shfaqur vetëm dy ditë më parë dhe në kohën kur dy pacientët tanë janë larguar nga ai qytet nuk ka patur më asnjë rast me koronavirus... ndërkohë në Shqipëri janë të paktën 3 vdekje nga sëmundje infective mushkrore super akute, për të cilat ekzistojnë të gjitha dyshimet se ishin vdekje nga koronavirusi të fshehura... kështu që ekziston çdo mundësi që rastet të jenë infektim brenda vendit. Shtoj këtu se gjatë një muajii janë bërë gjithsej 53 të dyshuarve analiza për koronavirus ndërkohë që janë bërë më shumë konferenca shtypi trillimi dhe mashtrimi nga Ndrikull Hajnia dhe zëdhënësit e tjerë të Edvin Çekapit. Dënoj me ashpërsinë më të madhe qëndrimin kriminal dhe të papërgjegjshëm të Edvin Çekapit dhe Ndrikull Hajnisë ndaj kësaj epidemie me vdekshmëri të lartë. Këta të papërgjegjshëm vetëm sot ndërprejnë fluturimet me Italinë e Veriut, ndërkohë që vetë Italia ka izoluar me ushtri ato zona dhjetëra ditë më parë. Po kështu Shqipëria sot është i vetmi vend në botë me një qendër të vetme për analizen e Koronavirusit. Ky është një krim i vërtet shtetëror i bërë me PPP-të e Edvin Çekapit dhe ndrikull Hajnisë.*

*Përveç këtyre për analizat për koronavirus nuk ka patur dënim kontroll çka e bën shumë të dyshimte vërtetësinë e tyre. Së fundi, asnjë përgatitje serioze nuk është bërë për përballimin me sukses të epidemisë. Mungojnë për publikun maskat, dizinfektantëtj...”*

Postim totalisht i pa vërtetë dhe panikngjallës.

4. Në datën 10.09.2020, ora 19:00 min, nëpërmjet postimit në rrjetin social Facebook me postimin “SOS”, i akuzuari deklaroi “*gjendje prag katastrofe në spitalin e Durrësit. Urgjenca kombëtare nuk transporton të sëmurin rëndë me Covid 19 në Tiranë sepse nuk ka autoambulanca me respirator. E sëmura prejditësh e shtruar në patologji për pneumoni. Dje është rënduar dhe future reanimacion me Covid-19. E sëmura ka infektuar në spital të sëmurë dhe personel nga Tirana, asnjë ndihmë. Ky është mashtrim kriminal me rastin zero i Edvin Çekapit dhe Ndrikull Hajnisë. Këto janë masat e marra për parandalim nga Edvin Çekapi dhe ndrikull Hajnia. Qëndrim kriminal.*”

Pavërtetësia e postimit faktohet nga qëndrimi zyrtar i Spitalit Durrës dhe Urgjencës Kombëtare, të cilët konfirmojnë krejt të kundërt.

5. Në datën 10.09.2020, në orën 22:00 min, nëpërmjet postimit në rrjetin social Facebook “*Një falenderim për kryeministrin e Italisë Conte... Edvini Hajduti dhe ndrikulla Hajnia me qëndrimet e tyre po bejnë çmos të fusin koronavirusin në Shqipëri. 25 shkurt 2020 ora 14:30.*

*Miq, Italia ka në një zonë të kufizuar të saj të përhapur infeksionin e koronavirusit. Qeveria Italiane shpalli dje masa rigorozë ndër të cilat kufizimin edhe të detyruar të lëvizjes, daljes së qytetarëve të vet nga zonat e infektuara për të shmangur përhapjen e koronavirusit në zona të tjera të Italisë. Madje Kryeministri Conte nuk u mjaftua me thirrjen drejtuar qytetarëve të këtyre zonave, por autorizoi policinë dhe u shpreh se në rast nevojë mund të përdorë edhe ushtrinë për zbatimin e këtij rregulli. Kurse Edvin “fatkeqësia” dhe “ndrikull” Hajnia në vend që të ndjekin praktikën e qëndrimit të shpallur nga qeveria italiane për banorët e këtyre zonave dhe t’iu bëjnë thirrje atyre shqiptarë apo italianë qofshin, që të mos vijnë dhe të mos lejojnë që ata të hyjnë në Shqipëri, deklarojnë pa asnjë pikë përgjegjësie se nuk do kufizojmë lëvizjet me Italinë. Sigurisht lëvizjet me Italinë në tërësi nuk duhen ndërprerë, por të mos kufizosh lëvizjet me zonën e infektuar të Italisë siç bëri dje qeveria italiane, do të thotë se për qëllime politike kriminale je i interesuar të sjellësh sa më parë koronavirusin në Shqipëri.”*

Duken qartë thirrje të qëllimshme për të përhapur panik, të pa bazuara në asnjë provë, fakt apo dokument zyrtar.

Në kushtet e rrethanat e mësipërme po paraqesim këtë kallëzim penal për ngjarje dhe fakte të pavërteta, të përhapura qëllimisht, të cilat përbëjnë elementë të veprës penale “Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik”, parashikuar nga Neni 267 i Kodit Penal.

## **I. LIGJI I APLIKUESHEM**

### **A. Kodi i procedurës Penale parashikon:**

#### ***Neni 280***

#### ***Marrja dajeni për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dajeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.....*

#### ***Neni 283***

*Çdo person që ka marrë dajeni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.....*

### **B. Kodi Penal parashikon:**

#### ***Neni 267***

*Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panik Përhapja e informatave apo njoftimeve të rreme, me fjalë, me shkrim apo me çdo mënyrë tjetër, me qëllim që të ngjallë një gjendje pasigurie dhe paniku te njerëzit, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*

## II. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE

Ne, grupit të deputetëve të Komisionit të Shëndetësisë, duke e konsideruar përhapjen e këtyre informatave si të rreme, të pabazuara në fakte dhe prova konkrete, duke krijuar nga i akuzuari një situatë mjaft të rëndë, me qëllim që të ngjallë gjendje pasigurie, paniku tek qytetarët, na lind detyrimi që t'i drejtohem organit të prokurorisë për të filluar procedimin penal ndaj të kallëzuarit, duke e çuar atë para drejtësisë, por edhe duke marrë masa preventive në mënyrë që të parandalohet kryerja e mëtejshme e këtyre veprimeve nga ana e tij.

I akuzuari, në mënyrë të vazhdueshme dhe të përsëritur, disa herë me anë të informatave të tij në rrjetin social Facebook, në formë të shkruar, ka përhapur informata të rreme të cilat kanë sjell pasiguri në jetën e qytetarëve.

Nëse i referohemi Nenit 267 të Kodit Penal, në të cilën parashikohet se: “Përhapja e informatave të rreme që ngjallin panic”, konkludojmë se në kuptimin objektiv të veprës penale, veprimet e të akuzuarit kanë cënuar marrëdhëniet juridike të cilat janë vendosur për të siguruar dhe garantuar rendin dhe sigurinë publike të mbrojtur posaçërisht me legjislacionin penal, nga veprimet dhe mosveprimet kriminale. Nga ana objektive kjo vepër është kryer nga i akuzuari me veprime të kundërligjshme, të shfaqura këto në mënyrë të përsëritur, duke dhënë informacione të rreme dhe panikuese tek qytetarët.

Po kështu, subjekti i veprës penale është një person me ndikim në publik, pasi ka mbajtur poste të rëndësishme, atë të Presidentit, Kryeministër i vendit dhe Deputet i Parlamentit të Republikës së Shqipërisë, dhe ka një numër të konsiderueshëm ndjekësish (pa përfshirë këtu referimin në këtë postim nga media të ndryshme), ç’ka ndikon shumë më tepër në mënyrën e servirjes së këtyre informacioneve tek qytetarët.

Për të provuar se postimet e të akuzuarit janë të rreme, nga ana jonë do të paraqiten prova të plota që do të provojnë të kundërtën e atyre informacioneve të paraqitura.

Disa nga komentet e qytetarëve të cilët provojnë faktin tonë të pretenduar po e faktojmë përsa më poshtë vijon:



Nimet Brakaj Më po cfare njeriu je .ti per detyrat qe ke pasur duhet te ishte nder te parat qe ti qetesojte njerzit fale edhe profesionit si doktor por ti bene te kunderten duke futur panik ne popull .ky veprim eshte i denueshem dhe ant shqiptar

Përgjigje: Përgjigje: 10



E. Lo Na Po ti per te dhene lajme te paverteta je i pan Sal digital Ne Firenze ka pasur dhe kete e dine te gjitha Ti as ne situata krike nuk je njerzor Shqiptaret ishalla i ruan Zoti se po te jete per ju moren fund

Përgjigje: Përgjigje: 11



1 personë

Neti Xhafa Virusi Sali mos fut panik ne popull duke ber gam gam jan shtete ku e ku para nesh dhe si po munden ta parandalon si po lutesh qe te ket te vdekur qe ta kthesh ne politike

Filipi Perqizu 20 Redaktuar



Ballafaqimi i postimeve me faktet dhe dokumentacionin pranë institucioneve shëndetësore, provon katëcipërisht se përhapja e këtyre informacioneve nga ana e të akuzuarit Sali Berisha konsumon elementet e veprës penale për të cilën e akuzojmë, pasi qytetarët janë të alarmuar për këtë situatë të paprovuar nga i akuzuari.

Kështu në lidhje me rastin e parë ku pasqyrohet nga i akuzuari përmes një video se në Vlorë po hidhej valle nga ana e grupit të mjekëve të spitalit provojmë se kjo video është e marrë nga rrjeti Youtube, për të cilin i'u kemi vënë në dispozicion linkun dhe autorësinë e kësaj video të cilën i akuzuari e ka transformuar duke fshehur të drejtën e autorit dhe duke e pasqyruar atë si video që vinte nga Spitali Rajonal Vlorë. Rezulton totalisht e provuar që kjo video është realizuar në Iran, fakt të cilin disa komentues qytetarë ia kanë vënë në dukje përmes komenteve. Njëkohësisht, shumë komentues të tjerë kanë pranuar si të mirqenë këtë video, duke shprehur frikën dhe pasigurinë dhe duke ulur besimin në institucionet shtetërore.

Po kështu, në artikullin referuar faktit se të sëmurët infektiv për shkaqe të ndryshme nga koronavirusi po trajtohen në të njëjtat ambiente me të infektuarit nga koronavirusi, duke përhapur këtë virus me ritme të shpejta dhe tek të sëmurët e tjerë, rezulton e provuar se ky është një njoftim i rremë. Referuar fakteve në Spitalin Infektiv, informacioneve zyrtare nga institucionet shëndetësore, ku media ka qenë prezente me vëzhgime dhe kronika konkrete dhe të vazhdueshme në terren, pa pasur asnjë referim apo raportim për këto ngjarje, janë marrë të gjitha masat për largimin e të sëmurëve të tjerë, përveç atyre me Covid-19, para momentit të postimit. Për më tepër njoftimi i publikuar në lidhje me këtë situatë, duket qartazi i rreme edhe sepse nuk është shoqëruar me asnjë foto në çfarëdo forme që ajo mund të ishte marrë, apo video që të provojë pretendimin e të akuzuarit. Në të kundërt të këtij pretendimi, konstatohet dhe provohet se në spitalin infektiv janë përshtatur dhoma dhe shtretër të veçantë për të infektuarit nga koronavirusi, madje këto janë pasqyruar edhe në komunikatat përkatëse të drejtuesve të këtyre spitaleve për publikun. Ky postim ka sjellë një pasiguri të madhe të qytetarëve dhe humbje të besimit tek Spitali Infektiv, pavarësisht se ky është një institucion profesional dhe serioz.

Përsa i përket postimit dt. 9 Mars 2020, ora 12:37, “Edvin Çekapi dhe Ndrikull Hajnia mashtrojnë shqiptaret”, provohet pa asnjë dyshim që është i rremë dhe me qëllimin e vetëm të ngjallë pasigurinë, duke sajuar situata që nuk janë shkak pasojë e njëra-tjetrës, kur dihet botërisht dhe e konfirmuar zyrtarisht, se në këto momente të informimit nga ana e tij në Shqipëri nuk ka patur të vdekur për këtë shkak, por dhe të infektuar kanë qenë vetëm dy shteteas të cilët kanë pranuar se kanë hyrë nga pika kufitare me Malin e Zi.

Po kështu i akuzuari në datën 10.09.2020 ora 19:00 deklaroi një gjendje prag katastrofe në spitalin e Durrësit. Urgjenca kombëtare nuk transporton të sëmurin rëndë me Covid -19 në Tiranë etj.

Ky informim, i bërë publik nga i akuzuari, është i rremë dhe me qëllim disinformimin dhe përhapjen e panikut për qytetarët e Durrësit pasi ky spital është i pajisur me mjetet e nevojshme për të përballuar situatën, si me mjetet respiratorë brenda ambulancave ashtu dhe me ambientet e krijuara për të përballuar situatën aktuale. Ky është një fakt i vërtetë pasi nga ana jonë në kontakte të vazhdueshme pranë këtij institucioni është provuar që janë të pajisura me këtë infrastrukturë të nevojshme për situatën.

Për situatën e krijuar shteti shqiptar me anë të Ministrisë së Shëndetësisë ka informuar planin e masave mbrojtëse të cilat duhet të respektohen nga ana e qytetarëve për të parandaluar përhapjen e virusit si dhe të mos marrin për bazë informimet e gabuara të kujtdo qofshin ato. Kështu në qëndrimet zyrtare të datave 9 dhe 10 Mars 2020 të MSH të cilat janë bërë publike, qartësohet me shifra konkrete gjendja aktuale e përhapjes së virusit dhe rezultatet e trajtimit të tyre.

Në kuadër të këtyre deklaramëve publike nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe nga ana tjetër e deklaramëve publike të të akuzuarit, do kërkonim nga ana juaj që të verifikohen përmes hetimit konkretisht këto fakte, për të provuar bindjen tonë të plotë se plotësohen të gjithë elementët e veprës penale, të parashikuar në nenin 267 të Kodit Penal.

Këto qëndrime të të akuzuarit, si edhe disa postime të tjera gjatë këtyre ditëve, të kryera në formën e një fushate të qëllimshme, jospontane, nga një person publik, me një numër të konsideruar ndjekësish, janë faktorë destabilizues dhe ndjellin panik për situatën, pasi qytetarët nëpërmjet këtyre informimeve mund të krijojnë bindjen dhe perceptimin se institucionet publike nuk funksionojnë në mënyrën e duhur, duke pasqyruar edhe mosrespektimin e protokollove për t'i bërë ballë përhapjes së virusit, si dhe çojnë në humbjen e besimit tek institucionet e specializuara, ç'ka do sillte përhapjen me ritme më të shpejta të epidemisë, si rrjedhim edhe rritje të numrit të viktimave.

Nëse i akuzuari këto deklaramë përpiket ti fshehi apo maskojë në kuadër të ushtrimit të lirisë së shprehjes, duhet të marrë parasysh që liria e shprehjes përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose *sigurisë publike*, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, *për mbrojtjen e shëndetit* ose të moralit. Kjo bëhet më sensibil në një situatë kritike e shqetësuese për shëndetin e qytetarëve. Ky ka qenë edhe synimi i legjislatorit, kur i ka dhënë mbrojtje të vecantë kësaj situatë, duke e konsideruar kriminale përhapjen e njoftimeve të tilla.

Bashkëngjitur keni edhe dokumentacionin provues të postimeve dhe prova të tjera që provojnë pavërtetësinë e tyre, por edhe përhapjen e panikut.

Në këto kushte të një rreziku evident dhe serioz, lind nevoja emergjente për kryerjen e veprimeve të shpejta hetimore, si dhe marrjen e masave paraprake të fshirjes, bllokimit dhe të ndalimit të përhapjes së lajmeve edhe në media të tjera nga i akuzuari.

Ne shprehim gjithë besimin se institucioni juaj, në bashkëpunim me gjykatën dhe kushtëzimet proceduriale, do të veprojë në mënyrë të shpejtë, efikase dhe pa ngurim, dhe presim me vëmendjen maksimale dhënien rrugë të këtij kallëzimi sipas procedurës përkatëse.

Çdo veprim i juaj në respekt të ligjit, nuk është thjeshtë një përgjigje ndaj veprimeve të qëllimshme panikuese të të akzuarit, por është edhe shprehje e ushtrimit të detyrës suaj institucionale dhe qytetare në mbrojtje të jetës dhe sigurisë publike, si dhe të vlerave e parimeve të demokracisë funksionale dhe shtetit të së drejtës .

Ne shprehim gadishmërinë tonë të plotë, për t'iu mbështetur në gjithë veprimtarinë tuaj gjatë këtij hetimi, të bindur se ju do të angazhoni seriozisht institucionin tuaj, për të ndalur të akzuarin dhe për ta vënë para drejtësisë sipas kompetencave dhe procedurës së parashikuar nga ligji.

Në pritje të një reagimi të shpejtë dhe efikas nga ana Juaj,

Me respekt,

#### KALLËZUESIT

##### Deputetët:

1. *Yllona Spakun*
2. *Arben Kamari*
3. *Edlira Penderaj*
4. *Almira Membrata*
5. *Polent Nalaj*
6. *Edlira Boole*
7. *Andriano Jolli*
8. *Florenc Spaho*
9. *Florida Buzhë*
- 10.